



REPUBLIK A E SHQIPËRISË
KUVENDI
Kryetarja

Nr. 4682 prot.

Tiranë, më 10.12.2024

U R D H Ë R

Nr. 86, datë 10.12.2024

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 12.12.2024, ORA 10:00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, dhe nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve për periudhën 25 nëntor – 13 dhjetor 2024,

U R D H Ë R O J:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 12.12.2024, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 5.12.2024.
 2. Njoftime.
 3. Interpelancë urgjente me ministren e Arsimit dhe Sportit, zonjën Ogerta Manastirliu, kërkuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike.
 4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë”, ratifikuar me ligjin nr. 57/2015”.
 5. Projektligji “Për miratimin e rritjes së kuotës së Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar”.
 6. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë për bashkëpunimin në mbrojtje ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera”.
 7. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2021 “Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare, sh.a.””

8. Projektvendimi “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.
9. Projektvendimi “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë”.
10. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 12 dhjetor 2024, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrit nr. 86, datë 10.12.2024 të Kryetares së Kuvendit, Znj. Elisa Spiropali, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 5.12.2024.
(Neni 44, pika 2, të Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime
(Neni 44, pika 3, të Rregullores së Kuvendit)
3. **Interpelancë urgjente me Ministrin e Arsimit dhe Sportit, Zonjën Ogerta Manastirliu, kërkuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike.**
(Neni 80 i Kushtetutës, neni 97 e Rregullores së Kuvendit).
4. **Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin “Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë”, ratifikuar me ligjin nr.57/2015”.**
(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)
Pyetje
Shprehet nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare)
Koha e votimit
5. **Projektligji “Për miratimin e rritjes së kuotës së Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar”.**
(Në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)
Pyetje

Shprehet nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare)
Koha e votimit

6. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë, për bashkëpunimin në mbrojtje ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera”.

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare)
Koha e votimit

7. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.90/2021, “Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare, sh.a.””. (Në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Europiane.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare)
Koha e votimit

8. Projektvendimi “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

(Në mbështetje të neneve 78, 179/b, pika 8, të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, 70, pika

2, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, neneve 18 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit.)

9. Projektvendimi “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë”.

(Në mbështetje të neneve 78, 179/b, pika 8, të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, 70, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 18 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit.)

10. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)